



Pranuar / Dorezuar Puniljeno/Prodato Received/Delivery	09.03.2022	2	viti god year
Organ /Njësia Organ /Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojta Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKUMSHCK	1266/2022		1/4



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.53/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi Bajraktari-kryetare, Eshref Shabani dhe Jeton Koca-anëtarë si dhe Valentina Kaçandolli Bekteshi-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.53/2022 të datës 24.01.2022 të parashtruar nga ankuesi Komuna e Obiliqit, në çështjen juridike “masës disiplinore”, kundër organit të punësimit Komuna e Obiliqit, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 08.03.2022, mori këtë:

V E N D I M

- I. SHFUQIZOHET** Vendimi me numër XII-171 i datës 29.12.2021, i Komisionit Disiplinor të Komunës së Obiliqit.
- II. OBLIGOHET** Komisioni Disiplinor në Komunën e Obiliqit që në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, të ndërmarr të gjitha veprimet procedurale dhe ligjore për ta *rishqyrtuar* lëndën e ankuesit
- III.** Obligohet Kryetari i Komunës së Obiliqit, që të ndërmarr të gjitha veprimet për zbatimin e këtij vendimi brenda afatit të përcaktuar nën pikën II të këtij vendimi.
- IV.** Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ndaj ankuesit punësuar në Komunën e Obiliqit, sipas Akt emërimit me numër II/05 datës 03.02.2017 në pozitën “Inspektor i Ndërtimit”, më datë 30.11.2021 Udhëheqësi i Inspektionit parashtron kërkesë me numër të referencës 32049 për iniciimin e procedurës disiplinore ndaj

Komisioni Disiplinor i Komunës së Obiliqit me datë 29.12.2021 nxjerr Vendim me numër XII-171 me të cilin vendim ankuesit i shqipton masën disiplinore “*ndalim i 20% të pagës për periudhën kohore prej 5 muajsh*”.

Ankuesi i pa kënaqur me Vendimin me numër XII-171 të datës 29.12.2021 të Komisionit Disiplinor të Komunës së Obiliqit me datë 24.01.2022 parashtron ankesë me numër të protokollit 301/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 27.01.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankuesit tek Komuna e Obiliqit, ndërsa Këshilli më datë 11.02.2022 ka pranuar përgjigjen në ankesë nga organi i punësimit me shkresat e bashkangjitura të lëndës faqe 1/97.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesa e ankuesit e datës 24.01.2022 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimi i datës 29.12.2021 i Komisionit Disiplinor; Kërkesa e datës 30.11.2021 për fillimin e procedurës disiplinore; E-mail i datave 03.12.2021, 30.11.2021, 01.12.2021, 17.12.2021, 28.12.2021; Proces verbalet e Komisionit Disiplinor i datës 06.12.2021, 20.12.2021, 23.12.2021, 29.12.2021; Plani kadastral me nr. të njësisë 1667-1-1919-1; Licenca me Nr.177; Aktvendimi i datës 14.08.2018 për leje ndërtimore; Procesverbali për kontrollin Inspektues i datave 18.09.2018, 26.10.2018, 08.02.2019, 20.02.2019, 12.04.2019; Njoftim për fillimin e ndërtimit i datës 23.11.2018; Inspektimi i fazave i datës 23.11.2018, 18.02.2020, 04.06.2020, 07.11.2020, 12.10.2021; Procesverbali i datës 12.10.2021; Raporti Final i datës 14.10.2021; Njoftimi i datës 16.11.2021 me numër V-1892; Njoftimi i datës 16.11.2021 me numër V-1893; E-mail i datës 24.11.2021; Kërkesa për raport final e datës 24.11.2021; Raporti javor i datës 15.10.2021, 12.11.2021, 10.08.2021; Procesverbali i datës 02.08.2021; Kontrata mbi Qiranë e datës 01.11.2019; Raporti i datës 19.08.2021; E-mail i datës 18.01.2022, 17.01.2022; Vendimi i datës 20.11.2020 mbi Emërimin e Komisionit Disiplinor; Akt Emërimi i datës 03.02.2017; Raporti final i datës 08.11.2021 me numër XV-213; Procesverbali i datës 28.10.2021, 30.04.2021; Vendimi i datës 03.09.2020 për Medruplast; Kërkesë për Raportet Final i datës 24.11.2021; Raporti javor i datës 15.10.2021, 12.11.2021; Raporti final i datës 13.10.2021; Procesverbal për kontrollin inspektues të datës 12.10.2021, 28.10.2021, 30.04.2021, 29.09.2020,; Njoftimi për fillimin e ndërtimit i datës 26.10.2018; Inspektimi i lokacionit i datës 26.10.2018; Inspektimi i fazave i datës 23.11.2018, 18.02.2020, 12.04.2020, 04.06.2020, 07.11.2020, 12.10.2021; Ditari Ndërtimor për Medruplast i datës 12.10.2020, 13.10.2020, 14.10.2020, 15.10.2020, 16.10.2020, 20.10.2020, 21.10.2020, 06.11.2020, 09.11.2020, 10.11.2020, 24.08.2020, 25.08.2020, 26.08.2020, 27.08.2020, 28.08.2020, 29.08.2020, 31.08.2020, 01.09.2020, 02.09.2020, 03.09.2020, 04.09.2020, 05.09.2020, 07.09.2020, 08.09.2020, 09.09.2020, 11.09.2020, 12.09.2020, 14.09.2020, 15.09.2020, 16.09.2020, 17.09.2020, 23.09.2020, 24.09.2020, 25.09.2020, 26.09.2020, 28.09.2020, 29.09.2020, 30.09.2020, 01.10.2020, 02.10.2020, 16.11.2020, 17.11.2020, 18.11.2020, 19.11.2020, 20.11.2020, 21.11.2020, 25.11.2020, 26.11.2020, 27.11.2020 si dhe përgjigja në ankesë nga organi i punësimit me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, në bazë të dispozitës së nenit 6 paragrafit 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës, ka konstatuar se ekziston baza ligjore që lënda ***duhet të kthehet në rishqyrtim në Komisionin Disiplinor, për shkak të shkeljeve procedurale dhe ligjore të bëra nga organi i punësimit gjegjësisht Komisioni Disiplinor.***

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, nga provat e lëndës ka konstatuar se ndaj ankuesit i punësuar në Komunën e Obiliqit, sipas Akt emërimit të datës 03.02.2017 në pozitën “Inspektor i

Ndërtimit", më datë 30.11.2021 Udhëheqësi i Inspektionit parashtron kërkesë me numër të referencës 32049 për iniciimin e procedurës disiplinore ndaj ankuesit

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka konstatuar se Komisioni Disiplinor pas pranimit të kërkesës me numër të protokollit 32049 të datës 30.11.2021 të parashtruar nga Udhëheqësi i Inspektionit ka shqyrtuar rastin e ankuesit dhe me datë 29.12.2021 nxjerr Vendim me numër XII-171 me të cilin vendim ankuesit i shqipton masën disiplinore „*ndalim 20% të pagës për periudhën kohore prej 5 muajsh*”.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka konstatuar se Vendimi me numër XII-171 i datës 29.12.2021 i Komisionit Disiplinor, është nxjerr në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, gjegjësisht me nenin 47 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1, 1.2, 1.3 dhe 1.4 dhe me nenin 48 paragrafi 2 që rregullojnë formën dhe elementet e detyrueshme të aktit administrativ, sepse rrjedhimisht vendimi nuk arsyeton gjendjen faktike dhe bazën juridike siç përcaktohet të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, sepse vendimi i lartë cekur përmban vetëm formulime të përgjithshme por mungon arsyetimi më i detajuar se me cilat veprime apo mos veprime ankuesi ka bërë shkelje të detyrave të punës.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka konstatuar se Komisioni Disiplinor i Komunës së Obiliqit, me rastin e nxjerrjes së Vendimit me numër XII-171 të datës 29.12.2021, ka vepruar në kundërshtim me dispozitat ligjore që përcaktojnë procedurën disiplinore dhe masat disiplinore për nëpunësit civil.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka konstatuar se Komisioni Disiplinor me Vendimin e datës 29.12.2021 nuk ka saktësuar se me cilat dispozita ligjore ankuesi ka vepruar në kundërshtim me Udhëzimin Administrativ MMPH Nr.05/2017 për Mbikëqyrje Inspektuese dhe Procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit e po ashtu ky komision ka cekur se ankuesi “*nuk ka respektuar hierarkinë përkatësisht mbikëqyrësin me rastin e lëshimit të raporteve të cekura më lartë*”, Kolegji konstaton se një konstatim i tillë nga ana e Komisionit Disiplinor është tejkalim i kompetencës rrjedhimisht jashtë kërkesës për iniciim të procedurës disiplinore të datës 31.11.2021 me numër 32049, po ashtu Komisioni disiplinor nuk ka arritur të vërtetoj drejtë gjendjen faktike dhe juridike duke mos i konstatuar drejt elementet e përgjegjësisë disiplinore, rrjedhimisht nuk ka konstatuar saktë përgjegjësin disiplinore të përcaktuar me nenin 45 të Ligjit Nr. 06/L-114 Për Zyrtarët Publikë, ku theksohet se: “*Përgjegjësia disiplinore është moszbatimi apo zbatim jo i duhur i detyrave të punës dhe detyrimeve të tjera ligjore, që përmban elementet si në vijim: 1.1. “ekzistimin e veprimit të paligjshëm apo mosveprimit;” 1.2. kryerjen e veprimit me faj apo mosveprimit; 1.3. ndodhja e pasojës 1.4. ndodhja e dëmit; dhe 1.5. lidhjen shkakësore ndërmjet veprimit të kryer dhe pasojës/dëmit*”, e që në rastin konkret, Komisioni disiplinor , nuk ka marrë për bazë deklarimin e ankuesit, të dhënat e ofruara dhe dokumentet e bashkangjitura me rastin e raportimit javor, andaj me të drejte Kolegji konstaton se Komisioni disiplinor me rastin e shqiptimit të masës disiplinore ndaj ankuesit përveç që nuk ka arritur të vërtetoj drejtë gjendjen faktike ai nuk ka arritur te vërtetoj as gjendjen juridike sepse, respektivisht nuk ka konstatuar shkeljet e kryera nga ankuesi, gjegjësisht nuk ka konstatuar që me veprimet apo mos veprimet e tij gjatë kryerjes së detyrës zyrtare ka bërë shkelje të lehta apo të rënda-serioze të detyrave të punës të përcaktuara me nenin 46 të Ligjit Nr. 06/L - 114 Për Zyrtarët Publikë, dhe Rregullores (QRK) Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publik

Me dispozitat të nenit 48 të Ligjit Nr.06/L-144 për Zyrtarët Publik si dhe nenit 11 të Rregullores Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publik, janë përcaktuar kompetencat e Komisionit Disiplinor, si në vijim: “*1. Komisioni disiplinor ka këto kompetenca:*

1.1. bene shqyrtimin e fakteve dhe provave të paraqitura; 1.2. përcakton dhe shqipton masën disiplinor”.
Në pajtim me dispozitat ligjore të lartë cekura, Komisioni Disiplinor ka mandat të dëgjoj dhe shqyrtoj

provat në lidhje me shkeljen e supozuar dhe që në bazë të provave të prezantuara të vendos nëse është kryer shkelja e supozuar si dhe të përcaktojë masën disiplinore, andaj Komisioni Disiplinor me rastin e rishqyrtimit të rastit disiplinor të inicuar ndaj nëpunësit është i obliguar që të vlerësoj të gjitha provat e bashkëngjitura të lëndës, duke marrë parasysh rrethanat rënduese dhe lehtësuese, të përcaktojë që me veprimet apo mos veprimet e tij gjatë kryerjes së detyrës zyrtare ka bërë shkelje të lehta apo të rënda-serioze të detyrave të punës dhe të vendos për shqiptimin e masës disiplinore në proporcion me shkeljen e kryer, në pajtim me nenin 50 paragrafin 2 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë të Republikës së Kosovës që ka përcaktuar se: **“Masat disiplinore jepen në raport të drejtë me shkeljen e kryer”** si dhe dispozitat përkatëse ligjore dhe nënligjore për procedurën dhe masat disiplinore në shërbimin civil, respektivisht të nxjerr vendim meritore për nëpunësin civil në pajtim me dispozitat ligjore të nenit 47 dhe 48 të Ligjit Nr.06/L-144 për Zyrtarët Publikë.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, duke marrë parasysh faktet e lartcekura ka konstatuar se Komisioni Disiplinor me rastin e nxjerrjes së Vendimit me numër XII-171 të datës 29.12.2021 ka vepruar në kundërshtim me dispozitat ligjore të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, Ligjit Nr.05/L-31 për Procedurën Administrative si dhe të Rregullores Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkrësive të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.6 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.53/2022

Valentina Kaçandoll Bekteshi

Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional

Malsore GASHI BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet

- Ankuesit
- Kryetarit të Komunës së Obiliqit;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Obiliqit dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

